


KOMPANIA E UJESJELLESIT RAJONAL  
**HIDRODRINI**  
SH.A. - PEJË  
Nr. 866 Data: 28.07.2023

Zyret qendrore

Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë  
Telefoni: 039 / 432 355  
[www.hidrodrini.com](http://www.hidrodrini.com)


Në bazë të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike ligji nr.03/L-087, i ndryshuar dhe i plotësuar më ligjet, nr. 04/L-042, nr.04/L-111, dhe numër 05/L-009. Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 28.07.2023, pas shqyrtimit të rregullores për matjen e konsumit të ujit dhe shtojcës së kësaj rregulloreje, njëzëri mori vendim për miratimin e kësaj rregulloreje dhe shtojcës së saj.

Vendim: Nr.3/2023



**RREGULLORE PËR MATJEN E KONSUMIT TË UJIT DHE SHTOJCA E  
KESAJ RREGULLOREJ**

	Delegoi:	Aprovoi:
Emri dhe Mbiemri	<b>Dri Cena</b> Kryeshf Ekzekutiv	<b>Jusuf Nikçi</b> Kryesues i Bordit të Drejtorëve
Nënshkrimi:		
Datë:	28.07.2023	28.07.2023



KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT  
SH. A. PEJË



Zyret Qendrore

Rr. Lekë Dukagjini nr 156 30000 Pejë  
Telefoni: 039 / 432 355  
[www.hidrodrini.com](http://www.hidrodrini.com)

**RREGULLORE**  
**PËR MATJEN E KONSUMIT TË UJIT**

PEJË-2023

## SHKURTESAT

---

<b>AKM</b>	Agjencia Kosovare e Metrologjisë
<b>ARRU</b>	Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit
<b>KRU</b>	Kompania Rajonale e Ujit
<b>ISO</b>	Organizata Ndërkombëtare e Standardeve
<b>KUR</b>	Kompania e Ujësjesit Rajonal
<b>OIML</b>	Organizata Ndërkombëtare e Metrologjisë Ligjore
<b>UA</b>	Udhëzimi Administrativ
<b>SH.A.</b>	Shoqëri Aksionare

Në mbështetje të nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, dhe të nenit 14, paragrafi 2 të Statutit të Kompanisë, Bordi i Drejtorëve të K.R.U 'Hidrodrini' Sh.A. Pejë.

Nxjerr këtë:

## **RREGULLORE PËR MATJEN E KONSUMIT TË UJIT**

### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Fushëveprimi dhe Qëllimi**

1. Kjo Rregullore ka për qëllim rregullimin e saktësisë së matjes së furnizimit të ujit, duke përcaktuar rregullat dhe procedurat e zbatueshme në lidhje me instalimin, mirëmbajtjen, testimin, kontrollin, zëvendësimin, matjen dhe leximin e ujëmatësve, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë.
2. Kjo rregullore vendosë një kornizë ligjore mbi të cilën kompania planifikon dhe ndërmerr veprimet specifike që duhet të ndiqen nga personeli i saj, me rastin e instalimit, mirëmbajtjes, testimit, kontrollimit, zëvendësimit, matjes dhe leximit të ujëmatësve.

#### **Neni 2 Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si vijon;
  - 1.1. Ditë Pune – çdo ditë përveç të shtunës dhe të dielës, apo ndonjë ditë tjetër që është festë zyrtare;
  - 1.2. Ujmatës – çdo aparat apo instrument të përdorur nga Ofruesi i Shërbimit për të matur sasinë e ujit të harxhuar nga konsumatori, për qëllime të faturimit;
  - 1.3. Kontrollimi i ujëmatësit – aktivitet për verifikimin e kushteve teknike dhe funksionalitetit të ujëmatësit;
  - 1.4. Testimi ujmatësit – aktivitet për verifikimin e saktësisë së matjes së ujëmatësit;
  - 1.5. Ekip i kontrollit – ekip i formuar nga kompania për kontrollimin e ujëmatësve;
  - 1.6. ARRU - Autoritet Rregullator për Shërbimet e Ujit;
  - 1.7. Autoriteti - ka kuptimin e njëjtë si të ARRU;

1.8. KRU - Kompania Rajonale e Ujësjellësit;

1.9. Kompani – ka kuptimin e K.R.U 'Hidrodrini' Sh.A. Pejë.

### **Neni 3 Zbatueshmëria**

1. Kjo rregullore është dokument zyrtar dhe i zbatueshëm i Kompanisë. Si e tillë ajo është e zbatueshme nga i gjithë personeli i Kompanisë që është i përfshirë në procesin e procesin e instalimit, mirëmbajtjes, testimit, kontrollimit, zavendësimit dhe leximit të ujëmatësve.
2. Mosrespektimi i kësaj rregulloreje paraqet shkelje të rregullave të punës dhe rrjedhimisht sanksionohet me masa ndëshkimore në pajtim me procedurat disiplinore të Kompanisë.
3. Për interpretimin e rregullave dhe procedurave të përcaktuara me këtë rregullore si dhe për zgjidhjen e keqkuptimeve eventuale apo rasteve të veçanta duhet të kontaktohet zyrtari përgjegjës – Sekretari i Kompanisë.

### **Neni 4 Korniza ligjore**

1. Korniza ligjore për matjen e konsumit të ujit është përcaktuar me:
  - 1.1 **Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit** i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në janar të vitit 2016.
    - 1.1.1 *Rregullore Nr. 10/2019 për Standardet Minimale për Shërbimet e Ujit;*
    - 1.1.2 *Rregullore Nr. 13/2021 për Kartën e Konsumatorit dhe Rregullimin e Marrëdhënieve Juridike ndërmjet Ofruesit të Shërbimeve dhe Konsumatorit*
  - 1.2 **Ligjin Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit**, miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2018.
  - 1.3 **Ligji Nr. 06/L-037 për Metrologji**, miratuar me datë 30 mars 2018.
    - 1.3.1 *Udhëzimi Administrativ (MTI) nr. 13/2020 për Kushtet dhe Kriteret Tekniko-Metrologjike për Autorizimin e Subjektit Juridik për Kryerjen e Veprimtarive për Shërbimin e Riparimit dhe Përgatitjen e Mjeteve Matëse për Verifikim (dhjetor, 2020)*
    - 1.3.2 *Rregullore Nr. 02/2021 për Mjetet Matëse Ligjërisht të Kontrolluara, (mars, 2021)*

### **Neni 5 Parimet e Kompanisë për matjen e konsumit të ujit**

1. Parimet bazë për matjen e konsumit të ujit janë të bazuara në legjislacionin e zbatueshëm dhe konsistojnë në sa vijon:

- 1.1. Secili konsumator duhet ta ketë të instaluar një ujëmatës kapaciteti dhe lloji i të cilit përcaktohet nga Ofruesi i Shërbimeve – Kompania.
- 1.2. Kompania e ka autoritetin ekskluziv për të instaluar, kontrolluar dhe zëvendësuar ujëmatësit.
- 1.3. Kompania duhet që faturimin e konsumatorëve për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizim ta bëj bazuar në matjen e konsumit të lexuar në ujëmatës.
- 1.4. Konsumatori është i detyruar të paguajë kostot që lidhen me instalimin, riparimin, dhe zëvendësimin e ujëmatësit.

## **II. RREGULLAT PËR PËR PËRZGJEDHJEN, VENDNDODHJEN DHE INSTALIMIN E UJËMATËSIT**

### **Neni 6**

#### **Tipet e ujëmatësve që mund të përdoren**

1. Në Republikën e Kosovës mund të vendosen në treg dhe të përdoren vetëm ato mjete matëse të cilat:
  - 1.1 i plotësojnë kërkesat nga ky ligj;
  - 1.2 i plotësojnë kërkesat tekniko-metrologjike të përshkruara me dispozita në zbatim të këtij ligji,
  - 1.3 të cilat kanë kaluar procedurat e përshkruara të vlerësimit të konformitetit.
2. Tipet e mjeteve matëse, miratohen nga AKM kur këto mjete matës i plotësojnë kërkesat teknike dhe metrologjike të parapara.
3. Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Metrologji, mjetet matëse që përdoren në Kosovë i nënshtrohen kontrollit ligjor metrologjik në pajtueshmëri me procedurat e vlerësimit të konformitetit që përfshin: (i) aprovimin e tipit, (ii) verifikimin fillestar, dhe (iii) verifikimin pasues.
4. Prodhuesi, ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, është përgjegjës për kryerjen e procedurave të vlerësimit të konformitetit dhe garanton se mjete matës përputhet me kërkesat metrologjike të përcaktuara.
5. Mjetet matëse të cilat i plotësojnë kushtet për tu përdorur në Kosovë, duhet që para se të vendosen në treg, të jenë të shënuara me shenja të përshkruara të konformitetit dhe të përcillen me dokumente të konformitetit sipas dispozitave ligjore.

### **Neni 7**

#### **Përzgjedhja e Ujëmatësve**

1. Përcaktimi i madhësisë (dimensioneve) dhe përzgjedhja e tipit të ujëmatësit është një nga hapat më të rëndësishëm në procesin e matjes së ujit.

2. Lloji dhe karakteristikat teknike të ujëmatësit përcaktohen nga Kompania, e cila gjithashtu përcakton prurjen nominale të ujëmatësit për secilin rast.
3. Përzgjedhja e dimensionit të duhur dhe tipit të ujëmatësit duhet të bazohet në llogaritjen e normave të rrjedhjes minimale dhe maksimale, si dhe duke u bazuar në grafikun e prodhuesit të ujëmatësve.

#### **Neni 8**

#### **Standardet përzgjedhjes së ujëmatësit**

1. Ujëmatësit duhet të jenë të llojit 'multi-jet' në përputhje me Direktivën nr. 2014/32/EU (Direktiva për Vënien në Treg të Instrumenteve Matëse) dhe OIML - R49 të Kërkesave teknike dhe metrologjike të ujëmatësve për ujë të ftohtë.
2. Ujëmatësi duhet të ketë aftësinë për të siguruar të dhëna elektronike (p.sh sinjal impuls), të jetë i përshtatshëm për të dërguar atë tek pajisjet ndihmëse të tilla si regjistruer i të dhënave ("datalogger"). Përcaktimi i madhësisë (dimensionimit) dhe përzgjedhja (selektimi) e tipit të ujëmatësve konsumues (individual) është një nga hapat më të rëndësishëm dhe shpesh të neglizhuar në procesin e matjes së ujit.

#### **Neni 9**

#### **Regjistrimi i konsumit të ujit**

1. Regjistrimi i ujëmatësit duhet të jetë i llojit që mundëson leximin vizuel dhe tregon qartë volumin total të ujit të matur.
2. Regjistruesi duhet të regjistrojë me m<sup>3</sup>.
3. Regjistruesi duhet të ketë mundësinë të lexojë të paktën deri 99 999,999 m<sup>3</sup>.

#### **Neni 10**

#### **Shenjat në ujëmatës**

1. Ujëmatësit duhet të kenë shenjat identifikuese si vijon:
  - 1.1 Shigjetën në të dy anët e trupit që tregon drejtimin e rrjedhjes;
  - 1.2 Emrin e prodhuesit dhe markën tregtare ("trademark");
  - 1.3 Prurjen nominale në m<sup>3</sup>/h;
  - 1.4 Presionin maksimal të lejuar në bar;
  - 1.5 Shenjën e konformitetit CE, shenjën e metrologjisë 'M' dhe dy shifrat e fundit që tregojnë vitin e prodhimit;
  - 1.6 Klasën e temperaturës;
  - 1.7 Numrin serik;

1.8 Shkronjën 'V' ose 'H' nëse ujëmatësi mund të operohet vetëm në pozitë horizontale ose vertikale;

### **Neni 11** **Lokacioni i ujëmatësit**

1. Konsumatori është i obliguar që për instalimin e ujëmatësit të sigurojë lokacion të sigurtë dhe i cili ka qasje në pajtim me standardet dhe rregullat e Kompanisë.
2. Konsumatori është i obliguar ta sigurojë dhe ta mbrojë ujëmatësin nga dëmtimet fizike.
3. Lokacioni për ujëmatës duhet të jetë:
  - 3.1 Në vend të përshtatshëm që mundëson qasje të lehtë për stafin e Kompanisë për qëllime të instalimit, leximit, mirëmbajtjes dhe zëvendësimit të ujëmatësit;
  - 3.2 I dimensioneve të mjaftueshme që mundëson instalimin, leximin dhe mirëmbajtjen e ujëmatësit;
  - 3.3 I kulluar nga ujërat të cilat do t'i vështirësonin aktivitetet operative që lidhen me leximin, mirëmbajtjen dhe zëvendësimin;
  - 3.4 I mbrojtur nga dëmtimet fizike dhe ato që rezultojnë nga ndryshimet e temperaturës.

### **Neni 12** **Lokacioni i ujëmatësit për shtëpi individuale**

1. Lokacioni i ujëmatësit për shtëpi individuale duhet të jetë:
  - 1.1 Brenda pronës së konsumatorit, dhe atë:
    - 1.1.1 jashtë ndërtesës, sa më afër kufirit të pronës – në distancë maksimale një metër e gjysëm (1.5) nga kufiri i pronës.
    - 1.1.2 në raste të veçanta, kur nuk ka vend për punimin e pusetës jashtë ndërtesës, me aprovim të Kompanisë, ujëmatësi mund të vendoset brenda ndërtesës.
  - 1.2 Jashtë pronës së konsumatorit, në hapësirë publike nëse kështu vlerëson Kompania dhe me kusht që të sigurohet leja nga organet përkatëse komunale

### **Neni 13** **Lokacioni i ujëmatësit për ndërtesa të banimit kolektiv**

1. Për të gjitha apartamentet ujëmatësit grupohen dhe të vendosen në një lokacion të përshtatshëm në bodrum sipas skemës standarde të dhënë në shtojcën e kësaj rregulloreje.
2. Në raste të ndërtesave të vjetra ku një zgjidhje e këtillë nuk është e realizueshme Kompania do të caktojë një vend i cili normalisht është:



- 2.1 jashtë apartamenteve në korridor,
  - 2.2 në raste të veçanta brenda apartamentit.
3. Lokacioni i ujëmatësve për ndërtesat e banimit kolektiv duhet të jetë në përputhje me kërkesat si vijon:
- 3.1 Duhet të ketë minimum njëqind (100) milimetra distancë ndërmjet ujëmatësve;
  - 3.2 Duhet të ketë qasje të lehtë tek ujëmatësit dhe ata duhet të jenë të lexueshëm nga dyshemeja;
  - 3.3 Duhet të ketë së paku një metër katror (1m<sup>2</sup>) hapësirë të lirë para kutisë së ujëmatësve;
  - 3.4 Duhet të ketë ndriçim adekuat gjatë orëve të ditës;
  - 3.5 Duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme që dyert e kutisë të hapen komplet dhe të qëndrojnë të hapura.

### **III. PROCEDURAT PËR INSTALIMIN, KONTROLLIMIN, VERIFIKIMIN, ZËVENDËSIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E UJËMATËSVE**

#### **Neni 14 Instalimi i ujëmatësit**

1. Para instalimit të ujëmatësit, tubi ku do të instalohet ujëmatësi duhet të shpërlahet për të larguar papastërtinë potenciale.
2. Ujëmatësi duhet të instalohet në pikë të ulët të tubit me shigjetën e drejtuar në drejtim të rrjedhjes.
3. Ujëmatësi duhet të instalohet në pozitë horizontale në mënyrë që të mundësohet punë optimale tij.
4. Para ujëmatësit duhet të instalohet një valvulë për të mundësuar instalimin e ujëmatësit dhe mirëmbajtjen e tij. Poashtu, duhet të instalohet një valvulë jokthyese në dalje të ujëmatësit me qëllim që të parandalohet kthimi pas i ujit.
5. Kur ujëmatësi nstalohet në tuba (gypa) plastike, duhet të sigurohet mbështetje adekuate me qëllim që të pengohet përkuhje (deformim) i madh i tubit.
6. Duhet të sigurohet mbrojtje adekuate, me vulën e Kompanisë, nga manipulimet abuzive për qëllime të detektimit të kurdisjes së ujëmatësit ose të regjistruetit të tij. Vula e Kompanisë e lidhur për trup të ujëmatësit dhe fittingjet e tubit, duhet të instalohet çdoherë kur të instalohet ujëmatësi i ri ose kur zëvendësohet ujëmatësi ekzistues;
7. Kompania duhet të mbajë shënime për lokacionin e ujëmatësve dhe detajet tjera të ujëmatësit si: lloji/modeli, diametri, numri serik, leximi fillestar dhe informacione tjera relevante.

**Neni 15**  
**Kontrollimi dhe testimi në vend i ujëmatësit**

1. Kompania zhvillon kontrole sistematike dhe 'ad-hoc' si dhe testime të ujëmatësve me qëllim të sigurimit të funksionalitetit dhe saktësisë së matjes të ujëmatësve, kontrole këto që konsistojnë në sa vijon:

1.1 Kontrole bazike rutinore që kryhen nga lexuesi i ujëmatësve;

1.2 Kontrollat rutinore dhe ad-hoc që kryhen ekipet e kontrollit.

**Neni 16**  
**Kontrollet e ujëmatësit nga lexuesit e ujëmatësit**

1. Kontrollet e ujëmatësit nga lexuesit e ujëmatësit përfshijnë:

1.1 inspektimin vizuel të lokacionit të ujëmatësit dhe të ujëmatësit;

1.2 mundësinë e qasjes tek lokacioni i ujëmatësit;

1.2 kushtet e pusëtës së ujëmatësit;

1.3 çfarëdo pengese/problemi për leximin e ujëmatësit (p.sh. puseta e mbushur me ujë, xhami i ujëmatësit i thyer etj.);

1.4 çfarëdo shenje të manipulimit me ujëmatës;

1.5 ekzistencën e vulës (pllombës) së ujëmatësit;

1.6 funksionalitetin e ujëmatësit.

2. Lexuesi i ujëmatësve duhet të mbajë shënime dhe të raportojë për gjetjet nga inspektimi i kryer.

**Neni 17**  
**Kontrollet e ujëmatësit nga ekipet e kontrollit**

1. Kontrollet dhe testimet e ujëmatësve nga ekipet e kontrollit duhet të kryhen së paku një herë në dy vite për secilin konsumatorë dhe duhet të përfshijnë:

1.1 qasjen tek lokacioni i ujëmatësit,

1.2 kushtet e pusëtës së ujëmatësit,

1.3 çfarëdo pengese/problemi për leximin e ujëmatësit (p.sh. puseta e mbushur me ujë, xhami i ujëmatësit i thyer etj.),

1.4 nëse ujëmatësi është instaluar në pajtim me udhëzimet për instalim,

1.5 tipin, numrin, dhe leximin e ujëmatësit,

1.6 instalimin e brendshëm të ujësjellësit për tu siguruar se të gjitha pikat e furnizimit me ujë janë përfshirë me ujëmatës,

1.7 çfarëdo shenje të manipulimit me ujëmatës,

1.8 ekzistencën e vulës (pllombë) së ujëmatësit,

1.9 funksionalitetin e ujëmatësit.

2. Kontrollimi i saktësisë së matjes së ujëmatësit kryhet me pajisje adekuate ose duke krahasuar një vëllim të ujit të regjistruar me një vëllim reference të ditur.

3. Detajet për kontrollimin e kryer duhet të shënohen në raport, forma e të cilit është dhënë në shtojcën 2, dhe raportohen tek eprori përgjegjës i ekipeve të kontrollit. Raporti duhet të shoqërohet me fotografi përkatëse për çfarëdo gjetje domethënëse të cilat duhet të dokumentohen.

### **Neni 18**

#### **Verifikimi i rregulltë dhe zëvendësimi i ujëmatësave**

1. Kompania kryen verifikimin e saktësisë së matjes dhe zëvendësimin e ujëmatësave në pajtim me programin që e harton për këtë qëllim.
2. Bazuar në legjislacionin e zbatueshëm dhe verifikimi i saktësisë së ujëmatësve kryhet çdo 5 (pesë) vjet.
3. Verifikimi i kryhet nga AKM ose personi juridik që është i certifikuar për verifikimin e ujëmatësve nga AKM.

### **Neni 17**

#### **Verifikimi i jashtëzakonshëm e ujëmatësve me kërkesë të konsumatorit**

1. Konsumatorët mund të kërkojnë verifikimin e saktësisë së matjes së ujëmatësit në çdo kohë.
2. Testimi kryhet nga AKM në laboratorin e personit juridik të certifikuar.
3. Rezultatet e verifikimit do tu jipen konsumatorëve me shkrim dhe Kompania do t'i mbajë rezultatet e testimit të kryer për një periudhë kohore jo më pak se 5 (pesë) vite.
4. Para se të kryhet verifikimi, konsumatori do të njoftohet për koston që ai duhet të paguajë dhe ai duhet të plotësojë formularin e aplikacionit (sipas shtojcës 4) që përmban dispozitën sipas të cilës ai pajtohet që të paguajë koston e verifikimit.
5. Konsumatori do të paguajë koston totale të verifikimit në rast se provohet se ujëmatësi punon brenda kufijve të pranueshëm të saktësisë së matjes. Nëse konstatohet se ujëmatësi matë jashtë kufijve të matjes e në dëm të konsumatorit, Kompania do të paguajë koston e verifikimit dhe koston e zëvendësimit të ujëmatësit.

6. Nëse ujëmatësi ka lexuar më tepër, Kompania do t'i bëj korrigjimet e nevojshme të faturës(ave) së konsumatorit, duke u bazuar në konsumin e periudhës me konsum të ngjajshëm retroaktivisht nga data kur vlerësohet se mbileximi të këtë filluar.

### **Neni 18** **Leximi i ujëmatësit**

1. Ujëmatësit lexohen nga stafi i autorizuar i Kompanisë që mund të jetë:
  - 1.1 Lexuesi i ujëmatësve;
  - 1.2 Inspektorët e Kompanisë.
2. Në të dyja rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, personi i autorizuar i Kompanisë duhet të këtë formë të duhur të identifikimit (uniforma me logon e Kompanisë dhe ID).
3. Leximi i ujëmatësve poashtu mund të bëhet nga Konsumatori në rast se Konsumatori dhe Kompania merren vesh për një gjë të tillë me shkrim. Në këto raste Kompania do të verifikojë ujëmatësin në intervale të caktuara kohore, jo më rrallë se një (1) herë në vit.
4. Leximi i ujëmatësve duhet të bëhet në intervale të rregullta çdo muaj dhe në asnjë rast më pak se një herë në (3) tre muaj.
5. Leximi i ujëmatësve në objektet e kultit fetar duhet të bëhet jo më rrallë se një herë në 6 (gjashtë) muaj.
6. Leximi i ujëmatësve mund të bëhet në mënyrë manuale ose në distancë - 'leximi automatik i ujëmatësve', varësisht prej llojit të ujëmatësit.
7. Kompania kryen kontrolle të rregullta dhe 'ad-hoc' të ujëmatësve me qëllim që të sigurohet saktësia e leximit.
8. Konsumatorët mund të kërkojnë shënimet për leximet e mëparshme të ujëmatësit për qëllime të krahasimit të konsumit aktual. Në këto raste, Kompania duhet të ofrojë këtë informacion pa pagesë.

### **Neni 19** **Mirëmbajtja e ujëmatësit dhe vulës (pllombës)**

1. Asnjë person i pa-autorizuar nuk guxon të manipulojë apo dëmtojë ujëmatësin apo vulën e ujëmatësit.
2. Çdo konsumator, ujëmatësi i të cilit është i vendosur në pronën e tij është përgjegjës për dëmtimet e ujëmatësit dhe dëmtimet e vulës së ujëmatësit që mund të rezultojnë nga neglizhenca, rrjedhja e ujit të nxehtë, ngrirja apo ndonjë faktorë tjetër që nuk është shkaktuar nga ofruesi i shërbimeve apo punëtorët e tij. Në këto raste kostoja e riparimit ose zëvendësimit të ujëmatësit apo vulës do të barten nga vetë konsumatori.
3. Kompania është përgjegjëse për mirëmbajtje, për dëmtimet e ujëmatësit dhe dëmtimet e vulës së ujëmatësve të cilët janë të instaluar (vendosur) në puseta në pronë publike. Në këto

raste kostoja e riparimit ose zëvendësimit të ujëmatësve apo vulës do të barten nga Kompania.

4. Në rast se ujëmatësi apo vula e ujëmatësit manipulohen nga konsumatori, Kompania, pas konstatimit të një veprimi të tillë, do të i'a ndërpres atij konsumatori shërbimet e ujësjellësit brenda pesë (5) ditëve të punës nga data e zbulimit. Poashtu, Kompania do të inicojë procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente ku do të vlerësohet edhe dëmi i shkaktuar nga konsumatori për mbulimin e:

4.1. Shpenzimeve të riparimit të ujëmatësit dhe/ose vulës;

4.2. Faturimit për konsumin e vlerësuar të ujit që konsiderohet se është konsumuar nga konsumatori e nuk është regjistruar në ujëmatës. Vlerësimi i ujit të konsumuar do të bëhet në bazë të konsumit të periudhës korresponduese në vitin paraprak.

#### **IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

##### **Neni 20 Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen të gjitha rregulloret, rregullat dhe vendimet e Kompanisë që kanë të bëjnë me procedurat e matjes së konsumit të ujit të konsumatorit.


##### **Neni 21 Hyrja në Fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të Kompanisë K.R.U 'Hidrodrini' SH.A –Pejë.



Datë:28.07.2023

### Shtojca 1: Skema e Instalimit të Ujëmatësve për Ndërtesa të Banimit Kolektiv



## Shtojca 2: Formati i Raportit të Inspektimit të Ujëmatësit

Nr. i regjistrimit: .....

Datë: .....

### RAPORTI I INSPEKTIMIT TË UJËMATËSIT

Konsumatori/Personi<sup>1</sup>: .....

Adresa: .....

Nr. Personal/Nr. Bisnesi: .....

Nr. i Kontrates: .....

✓ **Inspektimi bëhet:**

Me kërkesë të Konsumatorit - Nr....., Datë:.....
Inspektim i rregullt

• **Përshkrimi i Konstatimit**

Prodhimi i Ujëmatësit		Lloji i Ujëmatësit	
Diametri i Ujëmatësit		Numri i Ujëmatësit	
Gjendja (Leximi) e Faturuar e Ujëmatësit		Gjendja (Leximi) Aktual i Ujëmatësit	
Ujëmatësit funksionon po/jo			
Vula e Ujëmatësit (pllomba) (po/jo)			

• **Shënime:**


**Ekipi i kontrollit të Kompanisë**

**Konsumatori**

1 .....

2 .....

<sup>1</sup>Aplikohet për konsumatorët ilegal/te pa-autorizuar

**Shtojca 3: Formati i Raportit të Inspektimit të Ujëmatësit**

Nr. i regjistrimit: .....

Data: .....

**URDHËRESË E PUNËS  
PËR INSTALIMIN E UJËMATËSIT****Për :** \_\_\_\_\_*[Emri i hidraulikut/mjeshtrit]***Të dhënat e Konsumatorit të cilit i është instaluar ujëmatësi i ri:**

Emri			
Adresa			
Zona		Nr. i Kontratës	

*[Të plotësohet nga hidrauliku i ngarkuar]*

INSTALIMI I UJËMATËSIT TË RI		DEMONTIMI I UJËMATËSIT TË VJETËR *	
Emri i Prodhuesit:		Emri i Prodhuesit:	
Lloji:		Lloji:	
Numri Serik:		Numri Serik:	
Diametri nominal (mm):		Diametri nominal (mm):	
Prurja nominale (m <sup>3</sup> /h):		Prurja nominale (m <sup>3</sup> /h):	
Data e instalimit:		Data e demontimit:	
Numri i vulës (pllombës):		Leximi i matësit (m <sup>3</sup> ):	
<b>Vërejtje :</b>			

*\* Të plotësohet në rastet kur zëvendësohet ujëmatësi i vjetër*

Instalimi është bërë nga: \_\_\_\_\_ Konsumatori: \_\_\_\_\_

**Kopje:**

- Shefit të Departamentit të Shërbimeve të Konsumatorëve
- Operatorit të Faturimit

Konsumatorit



**Shtojca 4: Forma e Kërkesës për Verifikimin e Saktësisë së Ujëmatësit**

Nr. i regjistrimit: .....

Data: .....

[Të plotësohet nga Konsumatori]

**Unë pajtohem të paguajë të gjitha shpenzimet e demontimit të ujëmatësit dhe testimit të tij në përputhje me tarifat e aplikueshme të KRU \_\_\_\_\_ në rast se testimi i ujëmatësit rezulton të jetë i saktësisë së matjes konform standardeve të përcaktuara me ligj.**

Emri dhe Mbiemri:	
Adresa:	
Komuna:	
Nr. i telefonit (e-mail adresa):	
Numri i kontratës:	
Numri serik i ujëmatësit:	
Leximi i Ujëmatësit:	
Data e leximit të ujëmatësit:	

Kërkesës ia bashkangjes:

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i Konsumatorit: \_\_\_\_\_

Datë: \_\_\_\_\_

**Shtojca 5: Tabela Udhëzuese për Dimensinimin e Ujëmatësve**

Ujëmatësi			Lloji i Shfrytëzimit
Diametri	Lloji	Prurja	
15 mm (1/2")	Me fushë të thatë 'multi jet'	30-3,000 l/h	Shtëpi individuale, apartament, ose biznes i vogël (deri me 7 persona).
20 mm (3/4")	Me fushë të thatë 'multi jet'	50-5,000 l/h	Shtëpi të mëdha, shtëpi duplex, blloqe banimi, (deri 4 apartamente), dyqan berber, pompa benzine, institucione të vogla.
25 mm (1")	Me fushë të thatë multi jet	70-7,000 l/h	Residenca me pishina, ndërtesë banimi kolektiv me (4-12 apartamente), shkolla të vogla (deri 200 nxënës), institucione (deri 50 staf), kisha, xhami, motele të vogla (deri 10 dhoma), konsumatorë komercial të mëdhenj, kompleks dyqanesh (deri 10).
30 mm (5/4")	Me fushë të thatë 'multi jet'	120-12,000 l/h	Ndërtesa të banimit kolektiv (12-20 njësi), shkolla (deri 300 nxënës), hotele të madhësisë së mesme (deri 20 dhoma), motele (deri 25 dhoma), qendra të vogla tregtare, restorante, spitale të vegjël (deri 60 shtretër).
40 mm (6/4")	Dry dial 'multi jet'	200-20,000 l/h	Ndërtesa të banimit kolektiv (20-40 njësi), shkolla (deri 400 nxënës), hotele të madhësisë së mesme (deri 30 dhoma), motele (deri 40 dhoma), stacione të mëdha të benzinës me autolarje, qendra të vogla tregtare, restorante të mëdha, spitale të vegjël (deri 100 shtretër).
50 mm (2")	Me fushë të thatë 'multi jet'	450-30,000 l/h	Ndërtesa të banimit kolektiv (41-120 njësi), shkolla (deri 2000 nxënës), spitale të madhësisë së mesme ose qendra shoppingu, hotele të mesme apo motele, stacione të mëdha të benzinës me autolarje
75-100 mm	Kombinuar	120-100,000 l/h	Kompleks ose blloqe banimi (120-350 njësi), hotele apo motele të mëdha, spitale, qendra të zyrave, shkolla (mbi 2500 nxënës), qendra të mëdha tregtare, ndërtesa të qeverisë, objekte industriale.